




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raporti XII
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin gusht 2018





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e dymbëdhjetë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj të kaluar.

Si çdo muaj që nga krijimi i këtij institucioni, në emër të transparencës ju raportojmë kërkesat e ardhura nga ju gjatë muajit gusht si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Këto kërkesa/ankesa i gjeni në vijim. Gjithashtu dëshirojmë t'ju bëjmë me dije se politika për nxitjen e turizmit në vend po japin rezultatet e para. Turizmi i shtuar këtë vit ka patur një impakt të drejt për drejtë në hapjen e bizneseve të reja dhe më konkretisht në rritjen e ekonomisë familjare për secilin shqiptar. Mjafton të mendojmë se numri i bizneseve të reja në qarqet bregdetare u rritën me 21%, ndërsa rritja e xhiros në qendra të rëndësishme turistike si Durrësi, Vlora, Shkodra dhe Lezha, shënjoi +12%.

Mes ankesave të raportuara do të gjeni dhe propozime që zyra jonë ka marrë gjatë muajit gusht. Kini parasysh se çdo propozim që na mbërrin nga grupet e ndryshme të interesit, sipërmarrësit, apo shoqatat, koordinohet me ministrinë përkatëse të parashikuara për zgjidhjen specifike të secilës çështje, ndaj një pjesë e këtyre propozimeve janë në proces përpunimi dhe do të raportohen në vijim.

Ju lutem vijoni ta konsideroni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni çdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	02.08.2018	Subjektet raporton ankesë lidhur me cënimin e patentës dhe markës për material promocionale nga ana e dy shoqërive të tjera.	Trajtuar me përgjigje nga DPPT
Nr.2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	03.08.2018	Subjekti raporton ankesë lidhur me mosdorëzimin online të bilancit të shoqërisë për vitin 2017 dhe mos marrjen e këtij informacioni nga ana e QKB.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.3	Bashkia Tiranë	05.08.2018	Subjekti denoncon tatim me takse pasurie në kundërshtim me ligjin për objekt të pa përfunduar dhe të pa hipotekuar.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.4	Inspektorati i Përgjithshëm	06.08.2018	Subjekti depoziton ankesë mbi kontrolle/inspektime të shpeshta për ndotje të mjedisit.	Trajtuar me përgjigje dhe dhëni të informacionit sqarues.
Nr.5	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	08.08.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	09.08.2018	Subjekti depoziton ankesë mbi tarifën e larta të përdorimit të rimorkiatorëve.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.7	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.08.2018	Subjekti raporton gjobitje të padrejtë nga ana e Hetimit Tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.8	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.08.2018	Ankesë për mosmbyllje të NIPT nga ana e QKB.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.9	Ministria e Kulturës	14.08.2018	Ankesë mbi vendimet e Ministrisë së Kulturës në fushën e të Drejtave të Autorit.	Trajtuar me përgjigje nga Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	16.08.2018	Subjekti raporton ankesë për lajmërimin jashtë afatit nga ana e QKB.	Trajtuar me përgjigje nga QKB.
Nr.11	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17.08.2018	Subjekti kërkom rimbursim të TVSH-së kreditore.	Trajtuar me përgjigje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.12	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17.08.2018	Subjekti raporton refuzimin nga QKB të dokumenteve (bilancet e kompanisë) nga portali e-albania.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.13	APP	18.08.2018	Subjekti bën kërkesë për ndryshime në aktet nënligjore që kanë lidhje me procedurën blerjes me pakicë.	Analizim i propozimit dhe trajtuar me përgjigje.
Nr.14	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	20.08.2018	Subjekti bën kërkesë për pajisje me certifikatë për importin e kafshëve të gjalla në Shqipëri.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.15	APP	21.08.2018	Subjekti depoziton ankesë në lidhje me kriteret e kualifikimit për procedurën e prokurimit publik.	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.16	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22.08.2018	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.08.2018	Subjekti kërkon rivlerësim doganor.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.18	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	24.08.2018	Subjekti bën kërkesë për azhornim statusi në sistemin e tatimeve.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.19	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	25.08.2018	Subjekti raporton vështirësi likuiditeti dhe kërkon që DPT Tiranë të pranojë me ane të një aktmarrveshjeje shlyerjen me këste të detyrimit.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.20	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	26.08.2018	Subjekti raporton se AKBN i ka testuar shoqërisë investime të pa kryera, me situacione e fatura fiktive.	Trajtuar me verifikim të faturave përkatëse dhe kthyer përgjigje subjektit.
Nr.21	ZRPP Pogradec	26.08.2018	Subjekti raporton vonesa në pajisjen me certifikatë pronësie.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.22	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	27.08.2018	Subjekti raporton sit ë padrejtë gjobën e vendosur nga AKU.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.23	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	28.08.2018	Ankesë për përzgjedhje jo transparente të shoqatave të turizmit të cilat do të ushtrijnë veprimtarinë në fushën e turizmit.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.24	Bashkia Tiranë	29.08.2018	Subjekti bën kërkesë për informacion në lidhje me procedurat e aplikimit me qëllim pajisjen me leje perdorimi të hapësirës.	Trajtuar me dhënien e informacionit përkatës dhe ndjekjen e marrjes së lejes.
Nr.25	Ministria e Mjedisit dhe Turizmit	29.08.2018	Subjekti ankohet për pezullim të lejes mjedisore	Trajtuar me verifikim dhe përgjigje.
Nr.26	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës	29.08.2018	Subjekti depoziton ankesë për mbivendosje autorizimesh në ndertimin e HEC.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.27	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës	30.08.2018	Subjekti raporton mbifaturim nga ana e OSSHEE	Trajtuar me verifikim dhe zgjidhje.
Nr.28	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	30.08.2018	Subjekti bën kërkesë për rimbursim TVSH-je.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.29	Ministria e Drejtësisë	31.08.2018	Subjekti raporton vështirësi në regjistrimin e kontratave të kalimit të kredisq në sportelet e ADISA.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.30	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës	31.08.2018	Subjekti raporton ankesë në lidhje me mosrespektimin e afateve ligjore për dhënie licence.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.31	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	31.08.2018	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me zgjidhje.

